

Sigurimet Shoqërore

Pensioni i pleqërisë dhe ai i invaliditetit

2

Shëndeti dhe privatizimi

Përkeqësim për personelin dhe pacientët

3

Sindikatat në Kosovë

Nevojitet reforma dhe një ristrukturim

4

Nr. 2 | mars 2013 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Votimet nacionale të 3 marsit 2013

Prerja e parashutës së artë



Abzocker: Volk
1
Die StimmbürgerInnen haben den goldenen Fallschirm abgeschnitten

Me votë të qartë (67,9%) populli zviceran u deklarua kundër përfituesve zvatës. Pos kësaj u votua edhe pro iniciativës për pagë minimale në Kantonin Jura si dhe u refuzua zgjatja e orarit të punës të shtunave në territor të Konton Bazelit-qtetit. Rezultati tregon: Popullata nuk dëshiron që qindra mijëra punëmarrës të shfrytëzohen përmes pagave të ulëta, të cilat gati se nuk mjaftojnë për jetë, derisa të tjerët marrin paga milionëshe.

Pranimi i iniciativës kundër përfituesve zvatës dhe Po-ja e iniciativës popullore që ndalon pagat tepër të ulëta, janë sinjale të qarta për më shumë barazi ndarjeje. Popullata është ngopur me faktin se menaxherët e lartë dhe aksionarët e mëdhenj vit për vit grumbullojnë miliardat, përdërisa në anën tjetër heshtet skandalit i përhapjes gjithandej të pagave tepër të ulëta. Mesazhi është i qartë: Politika duhet së fundi ti jap fund mentalitetit të vetëshërbimit nga ana e menaxherëve të lartë dhe tua mbyllë shtegun. Dhe politika duhet ti përvishet punës kundër skandalit të pagave tepër të ulëta në Zvicër e pasur.

Të përfundojë skandalit i pagave të ulëta

Gjithmonë top menaxherët me përfitime milionëshe dhe parashuta të arta për çudira. Pak më i njohur – por gjithashtu skandaloz – është fakti, se: Derisa disa veta të pakët në numër pasurohen paturpësisht, në Zvicër kemi 440000 punëmarrës dhe familjarë të tyre që janë të prekur nga pagat nën 4000 franga. Kjo pagë nuk mjafton për të bërë jetë me dinjitet. Qëndrimi i përfaqësuar nga ana e punëdhënësve se nëse paga nuk mjafton njeriu mund të drejtohet për ndihmë sociale, konsiderohet me të drejtë si cinizëm.

Tani është koha për zbatim

Një iniciativë është një hap në drejtimin e duhur, mirëpo si e vetme ajo nuk mund tua ndalë turrin përfituesve zvatës. Pagat e menaxherëve qartas duhet të kufizohen në lartësi. Këtë e parasheh iniciativa 1:12 e socialistëve të riinjë (Juso). Kjo iniciativë synon që askush të mos fitojë më pak se sa fiton për një muaj menaxheri i paguar më së miri i së njëjtës ndërmarrje. Pasi sot një top menaxher fiton 73 herë më shumë se sa një punonjës me pagën më të ulët. Mbi këtë iniciativë parashikohet të votohet në vjeshtë të këtij viti.

Jura me pagë minimale ligjore

Pas Neuenburg-ut është Jura kantoni i dytë, i cili fuqizon pagën minimale. Iniciativa popullore, të cilën e ka mbështetur aktivisht Unia, është pranuar me 54,2% të votave. Problemi i pagave të ulëta dhe shtypja e pagave në rritje duhet të zgjidhet në nivel të tërë vendit. Me iniciativën për pagën minimale të sindikatave, e cila kërkon një pagë minimale ligjore prej 4000 frangave dhe mbrojtje më të mirë për pagat, shtron një zgjidhje të tillë në tavolinë. Unia kërkon nga përfaqësuesit e popullit në Bernë që gjatë këshillimeve parlamentare të mbështesin iniciativën për pagën minimale.

Jo orarit të zgjatur të punës në shitore në Bazel

Popullata me të drejtë vote e Bazelit ka refuzuar zgjatjen e orarit të punës deri në ora 20 të shtunave. Parapikisht në votimet e ngjashme në Kantonet e Cyrihut, Luzernit, St. Gallenit dhe Gjenevës qytetarët kanë votuar kundër zgjatjes të orarit të punës dhe me këtë rast kanë sinjalizuar qartas: Popullata është e kënaqur me orarin aktual të punës së shitoreve dhe e vlerëson më të rëndësishëm mbrojtjen e të punësuarve se sa interesat përfituese të shpërndarëve të mëdhenj. Unia kërkon nga qeveria dhe parlamenti të respektoj më në fund vullnetin e popullit dhe të refuzojë zgjerimin e orarit të punës edhe të dielave (Mocioni Abate) dhe zgjerimi masiv e orarit ekzistues të punës gjatë ditëve javore të punës (Mocion Lombardi).

Aurora Garcia



Orari i pandërprerë i punës

Editorial



Të dashura / a lexues / e

5260. Kaq vite do ti duhej të punonte një punëtori me një pagë mesatare (6000.- frangash) për të mbërrirë 420 000 000 frangat, të cilat i foton z. Vasella tek Novartis! Pagat tepër të larta të Vallesës me kompani japin gjithmonë shkas për indinjatë dhe habi: çfarë kontributi të jashtëzakonshëm japin këta zotëri dhe shumë pak zonja, për të fituar kaq më shumëfish se sa një punëtor i zakonshëm? Dhe me gjithë padrejtësinë flagrante këto paga nuk janë problemi i vërtetë i sistemit tonë ekonomik – ato janë vetëm simptoma të një sëmundjeje shumë më të rrezikshme: pushteti i pakufishëm i financave, i ultra liberalizmit, si dhe pengmarrës i politikës.

Vendet jugore të Evropës e njohin këtë: Për pagat e menaxherëve dhe për Bankat nuk mungojnë paratë dhe mbështetja shtetërore. Mirëpo popullata e gjerë jo vetëm se duhet gjithnjë e më shumë të paguaj tatim të lartë, por bëhen edhe kurtime në kurriz të saj. Politikanët përsërisin pandërprerë, që shteti social është tepër i shtrenjtë dhe kursejnë në shëndetësi, arsim në sigurimet shoqërore, mirëpo jo tek përfituesit zvatës të botës së financave. Qëllimi është, të minohet shteti social dhe të krijohet fuqi e lirë pune. Kjo prodhon varfëri, nga e cila Vallesat e kësaj bote fitojnë shumë para. Por tani populli zviceran me pranimin e iniciativës kundër përfituesve zvatës dha një sinjal të qartë të pakënaqësisë së tij. Me këtë është mbyllur vetëm një plagë e vogël. Ultra liberalizmi është duke u zgjeruar pandalshëm dhe është duke i lënduar për vdekje ekonominë nacionale. Kjo është një sëmundje e vërtetë kundër së cilës duhet të luftojmë të gjithë ne.

Marilia Mendes

Sekretare sindikale për migracion dhe anëtare e redaksisë

News

KPP: Për shitoret në pikat e karburanteve në Fribourg



Nga 1 marsi Fribourg-u është kantoni i parë ku vlen detyrimisht Kontrata e Përgjithshme e Punës për shitoret në pikat e karburanteve. Qeveria ka reaguar pozitivisht në kërkesën e bërë nga sindikatat Unia dhe Syna. Deri më tani kësaj Kontrate i nënshtroheshin vetëm rreth 3/4 e anëtarëve të shoqatës së punëdhënësve të shitoreve në pikat e karburanteve. Më këtë sindikatat duan të pengojnë përkeqësimin në rritje të kushteve të punës nëpër këto shitore.

Konferenca: e sektorit të sigurisë

Më 12 shkurt u zhvillua konferenca e sektorit të sigurisë. Një delegacion i shoqatës së punëmarrësve VVSU ishte prezent dhe paraqiti propozimet e tija për revidimin aktual të KKP-së. Gjatë diskutimit erdhi në shprehje nevoja absolute sa i përket obligimit për evidentimin e orarit të punës si parakusht për të mundësuar kontrole të qëndrueshme. VVSU e kuptoi më në fund se kjo çështje duhet të rregullohet. Më tej delegatët diskutuan strategjinë që duhet ndjekur: Modeli ABC i VVSU-së është bazament për bisedime dhe delegatët e kanë të qartë se cilat pika duhet të përmirësohen. Në fund delegatët u desh që për shkak të dorëheqjeve të ndryshme të zgjedhin delegacionin e bisedimeve dhe të dy kryetarët. Konferenca e ardhshme e sektorit mbahet më 4 qershor.

Revidimi i ligjit të shtetësisë: Propozimet e KPSH

Pengesat për marrjen e shtetësisë në Zvicër duhet të rriten. Këtë e dëshiron Komisioni për Politika Shtetërore i Parlamentit të Zvicrës. Aji i propozon kuvendit të përkeqësorë Ligjin për Drejtën e Shtetësisë. Përkeqësimi prek personat me leje të përkohshme: nëse dikush jeton me vite si i pranuar përkohësisht në Zvicër, këto vite nuk llogariten më tej për marrjen e lejes së qëndrimit. Përkeqësime tjera prekin të rinjtë: Komisioni nuk donë që koha nga mosha 10 deri 20 vjeç e jetës në Zvicër të mos llogaritet dyfish sikur deri më tani. Me revidimin e Ligjit për Shtetësi qeveria dëshiron të harmonizojë procedurën. Leja e përhershme e qëndrimit rrishtas duhet të jetë parakusht për marrjen e shtetësisë. Kjo mund të jepet tani nga 8 vite – dhe jo 12 vite sa ishte deri më tani – leje qëndrimi të përhershëm. Shumica e Komisionit donë që kufiri të përcaktohet në 10 vite.

Ndryshimet në Sigurimet Shoqërore 2013

Pensioni i pleqërisë dhe invaliditetit (AHV/AVS e IV/AI)

Përkujdesa në pleqëri, kolona e dyte dhe e tretë, shtesat familjare etj.: Këtë vit kemi ndryshime gjithandej në Sigurimet Shoqërore

Pensionet e pleqërisë (AHV/AVS)

Çdo dy vite pensionet do tu përshtaten zhvillimeve të pagave dhe të çmimeve. Që nga fillimi i 2013-ës sendorët do të marrin pensione më të larta të pleqërisë. Pensioni minimal i pleqërisë rrishtas do të jetë 1170 franga, ndërsa maksimali 2340 franga; shuma më e lartë e pensionit të bashkëshortëve rrishtas është përcaktuar me 3510 franga.

Kompensimi për të paaftët

Edhe kompensimet për të paaftët në kuadër të sigurimeve të pleqërisë rriten: Në kompensim kanë të drejtë pensionistët të cilët në përditshmëri kanë gjithmonë e më shumë nevoja për ndihmë. Me rëndësi: Kompensimi nuk paguhet automatikisht, porse duhet të bëhet përmes kërkesës. Në rast të një shkalle paaftësie të lartë është 80% e pensionit minimal të pleqërisë. Nevojtarët me shkallë të lehtë paaftësie marrin 20% (234 franga) kompensim.

Edhe pensionistët e invaliditetit (IV/AI) kanë të drejtë në kompensimin për të paaftët. Ky kompensim për paaftësi të rëndë është 1872.– franga, për ata me paaftësi mesatare 1170.– franga, ndërsa për paaftësi të lehtë është 468.– franga.

Kontributet minimale të Sigurimit të Pleqërisë (AHV/AVS)

Gjithashtu janë rritur edhe kontributet në sigurimet e pleqërisë (AHV/AVS), që duhet të paguajnë të pa-



Gra pensioniste gjatë protestës

punët dhe të pavarurit, e të cilët fitojnë më pak se 9400 franga në vit. Ata kontribuojnë me 480 franga në vit. Kontributi më i lartë korrespondon 50 herë me kontributin minimal, pra me 24000 franga. Edhe kontributet për sigurimin vullnetar ngritën për së paku 914 franga. Vullnetarisht mund të sigurohen qytetarët dhe qytetarët e Zvicrës, ata të BE-së dhe të shteteve anëtare të Zonës së Lirë Tregtare Evropiane, të cilët kalojnë në një vend jashtë BE-së deh jashtë kësaj zone dhe të cilët për 5 vite pandërprerë kanë paguar kontributet e sigurimit të pleqërisë (AHV/AVS).

Pensionet e Invaliditetit (IV/AI) dhe të ardhurat suplementare (EL/PC)

Ashtu sikur pensionet e pleqërisë rriten edhe ato të invaliditetit: pensioni (i plotë) minimal i invaliditetit është 1170 franga, ai maksimal 2340 franga.

Për pensionistët e invaliditetit, të cilët janë më të ri se 20 vjeç deh të cilët për shkaqe të defekteve të lindura trajtohen në institucione stacionare, sigurimi i invaliditetit (IV/AI) rrishtas merr përsipër vetëm 80% të kostove, ndërsa pjesën tjetër të harxhimeve e merr përsipër Kantoni i vendbanimit.

Mirëpo trajtimi duhet të ofrohet nga një Spital që njihet nga Ligji për Sigurime Shëndetësore.

Kontributet për mbulimin e harxhimeve të nevojave të përgjithshme jetësore të të ardhurave suplementare (EL/PC) janë rritur.

Kolona e dytë

Në Sigurimin Profesional (BVG/LPP) janë ngritur të ashtuquajturat shumat kufitare. Rrishtas duhet që të pranohen në shtyllën e dytë të sigurimeve të gjithë personat, të cilët fitojnë së paku 21060 franga. Paga maksimale (e përkufizuar), për të cilën janë siguruar kontributet e fondit të sigurisë së Sigurimit Profesional (BVG/LPP), është ngritur nga 125280 në 126360 franga. Ky fond sigurie garanton përfitimet nga institucioni siguries, nëse këtij i duhet të lajmërojë paaftësinë e pagesës. Përqindja kufizuese e kontributeve për komtat shtesë në rast të strukturës së pavolitshme të moshave është 0,08% (ishte 0,07%). Këto para duhet që Arkat e Sigurimit Profesionale ti paguajnë në fondet e sigurisë.

Shtesat Familjare

Rrishtas të pavarurit (përveç në bujqësi) kanë të drejtë në shtesat familjare. Të gjithë të pavarurit i nënshtrohen ligjit dhe duhet të anëtarësohen në arkën së kompensimit familjar.

Kolona 3 a

Heqja maksimale nga tatimi për investim-kursimet në kolonën individuale 3 a është rritur. Për personat, të cilët janë të siguruar në kolonën e dytë, tani shuma e kontributit është 6730 franga (deri më tani ishte 6682 franga). Kush nuk ka kolonë të dytë, mund të zbriti nga tatimi 33696 franga (deri më tani 33408 franga).

Aurora Garcia

KPP e Coop-it

Bisedime për KPP e Coop-it: më shumë mbrojtje dhe paga korrekte



Protestë e punonjësve të Coop-it për kushte më të mira pune

Këtë vit kalon afati i KKP për Coop-in, andaj bisedimet do të fillojnë këtë pranverë. Më 2014 duhet të kemi KKP-në e re, kur KPP e Coop-it ka 100 vjetorin jubilar. Delegatët e konferencës sektoriale të Unia-s kërkojnë përmes një peticioni kërkojnë më shumë mbrojtje nga fleksibiliteti dhe një KPP të mirë për të gjithë.

Në dhjetë vitet e kaluara përqindjet, fitimi dhe prodhimtaria e ndërmarrjes Coop është rritur, në këto dhjetë vitet e fundit përfitimi u rrit për 43%. Ndërsa personeli në të kundërtën gjendet para një presioni të shtuar dhe i duhet të përballojë orarin elastik dhe të zgatur të punës. Krahas kësaj stagnojnë edhe më tej pagat për punonjësit shumëvjeçar.

Peticioni për më shumë mbrojtje

Kjo duhet të ndryshojë, pasi delegatët kërkojnë një përmirësim të Kontratës së Përgjithshme të Punës (KPP) në pika vijuese:

1. Më shumë mbrojtje nga fleksibiliteti përmes kufizimit të orëve plus ose minus dhe orarin e zgatur në ditës e punës.

2. Paga korrekte përmes rritjes së pagave minimale, duke përlogaritur përvojën dhe përgjegjësinë, përmes barazisë në paga dhe transparencës së pagave.

3. Kontratë më të mirë të Përgjithshme të Punës për të gjithë, përmes jetësimi të partneritetit social duke zgjedhur delegatët sindikal me të drejta dhe detyrime të qarta, për të mundësuar respektimin dhe kontrollimin e Kontratës së Përgjithshme të Punës nëpër filialet.

Për tu dhënë këtyre kërkesave një peshë të fuqishme, të gjitha këto do të përmblihen në një peticion të personelit dhe më pas do të mblidhen nënshkrimet. Pasi edhe punonjësit e Coop-it kanë të drejtë të një pjesë të kulaçit.

Aurora Garcia

Shëndetësia, Privatizimi

Një valë privatizimesh përfshinë spitalet e Zvicrës

Që nga nëntori 2012, 22 punonjës të Spitalit La Providence në Neuchâtel luftojnë kundër privatizimit të spitalit të tyre. Kjo luftë punëtorë tregon në mënyrë ekzemplare çfarë pasojash bartë me veti financimi dhe privatizimi i spitaleve publike si për punonjësit ashtu edhe për pacientët.



Pamje nga protesta kundër privatizimit në shëndetësi

Spitali La Providence para pak kohësh iu është bashkangjitur grupit të klinika ve private Genolier. Pa-suan pushimet nga puna, zhvendosjet dhe anulimi i Kontratës së Përgjithshme të Punës, të cilat janë paralajmëruar qysh vitin e kaluar. La Providence i takon rrjetit të spitaleve të cila ofrojnë shërbime publike (të ashtuquajtura Service-Public) dhe për këtë arsye marrin subvencione shtetërore. Këto spital si kundër-shpërbllim duhet të zbatojnë Kontratën e Përgjithshme të Punës (KPP) të Spitaleve «Santé 21». Qeveria kantonale e Neuenburgut pajtohet me këtë përfundim. Të 22 grevistët, të cilët kundërshtojnë anulimin e KPP-së, u përjashtuan pa afat hë për hë nga puna. Është bërë një padi, vendimi është ende i hapur.

Financimi i ri i spitaleve: Presion për spitalet

Rasti i La Providence paraqet anë të pakëndshme të privatizimit, zhvendosjeve dhe financimin e futur në fuqi në vitin 2012. Qe një vit spi-

talet subvencionohen përmes të ashtuquajturve raste paushall: Spitalet nuk marrin më pagesën për harxhimet efektive, por paushallët e rasteve. Kjo domethënë, për çdo diagnozë, për çdo operacion do të përcaktohet se sa guxon të kushtojnë ato. Paushallët, pra shumën e kostove për çdo rast spitali e merr nga shteti. Nëse një operacion kushton më shumë, duhet që spitali të paguaj vet, nëse harxhimet janë më të vogla, spitali shënon fitim. Andaj secili spital është i interesuar të punojë në atë mënyrë për të gjenuar mundësisht sa më pak kosto. Kontributet duhet të shkurtohen në mënyrë konsekuente. Gjithmonë e më shumë spitalet për këtë shkak kanë vështirësi financiare. Për klinika private si Genolier, kjo është një lojë e lehtë, ti marrë përsipër këto spitalet dhe të zgjerojë lëmin e vet të ndikimit.

Kushte të këqija pune dhe medicinë dy-klashe?

Si pasojë e kësaj është i dukshëm edhe zvogëlimi i kualitetit të shërbimeve shëndetësore. Pacientët shërohen me dobëti, pasi që shpejt e shpejt dërgohen në shtëpi, për tu mbajtur kostot ulëta, ndërsa shërimi megjithatë kushton. Spitalet janë gjithnjë më të interesuara të kenë si pacientë të pasuri, të cilët edhe mund ti paguajnë shërbimet kushtuese. Në këtë situatë vuajnë gjithashtu edhe të punësuarit: zgjatje orarit të punës, më pak pagë shtesë për punën natën dhe të die-lave, sektorë të caktuar të ngarkuar, etj. Kështu personeli sipas kredos së pritur «fleksibel», duhet të mbajnë koston sa më të ulët. Profesionit i infermierisë gjithnjë e më pak po është atraktiv, gjë që qon në arsimimin e sa më pak personave dhe rrjedhimisht edhe në zvogëlimin e personave që duan të kryejnë këtë punë.

➤ Aurora Garcia

Vazhdon maratona e (mos)marrëveshjes

Pensionet e Zvicrës

Pensionistët kosovarë që kanë punuar në Zvicër, ende nuk po mund t'i gëzojnë kontributet e tyre prej vitesh në shtetin e Zvicrës. Kosovarët, në pension të pleqërisë ose të invaliditetit në Zvicër, e të cilët kanë vendosur të jetojnë në vendlindje, nuk po mund ta shijojnë sa duhet atë.

Kjo ndodhë pasi që Enti Federal për Sigurime Sociale i Zvicrës vazhdon të refuzojë pagesën e të hollave për personat me sigurim pensional dhe atij të invaliditetit nga ky shtet, e të cilët jetojnë në Kosovë.

Faj kanë të dy qeveritë

Njëri nga ta është edhe Avdush Kadriu i cili sapo ka arritur moshën e pensionit e që nuk po mund t'i gëzojë paratë nga kontributi i tij i dhënë në Zvicër. Sipas tij, shteti Zviceran ka ofruar një shumë simbolike të të hollave sipas tij veç sa për të mbyllur një

marrëveshje, e që ai nuk e ka pranuar. E i zëshëm ka qenë Osman Osmani, ekspert i migracionit dhe sindikalist i UNIA-s në Zvicër i cili fajin ia hedhë dy qeverive, të Zvicrës e sidomos asaj të Kosovës. Sipas Osmanit, qytetarët që e gëzojnë këtë të drejtë, nuk mund të jenë pre e mosmarrëveshjeve apo mos zbatueshmërisë së marrëveshjeve ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës. Sipas Osmanit, argumenti i Zvicrës që Kosova nuk ka institucione partnere, nuk qëndron ngase Zvicra nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Kosovën vazhdimisht, ashtu



Mbështetje për të moshuarit

sikurse edhe Kosova, nuk po zbaton rekomandimet e dala nga kuvendi për ri negociim të marrëveshjes.

Mungesë serioziteti

Por, nga ana tjetër Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, fajin ia hedhë qeverisë Zvicerane, e cila nuk ka bërë asgjë pavarësisht, kërkesave nga ana e Ministrisë. Mos zbatimin e kësaj marrëveshje nga ana e Zvicrës, Ministri thotë se ndikon edhe mungesa e ligjit pensional. Zvicra që nga prilli 2010 nuk vijon të zbaton Marrëveshjen për Sigurimet Shoqërore të lidhur me ish Jugosllavinë në raport me Kosovën. Por Gjykata Administrative Federale e Zvicrës kishte gjykuar se kosovarët posedojnë detyrësinë, rrjedhimisht edhe kosovarët duhet të kenë të drejtë për pensionet, e të cilën refuzon ta zbatoj Enti Federal për Sigurime Sociale.

➤ Marrë nga portali tung.ch, 27.2.2013



Pensionistët e Kosovës duke pritur pensionet para sporteleve të MPMS

Intervista qarkullimi i lirë i personave



Rita Schiavi, përgjegjëse për migracionit dhe anëtare e stafit drejtues në Unia

Klauzola ventil: Rrezik për përkeqësim të kushteve të punës

Qeveria dëshiron që në pranverë të aktivizojë klauzolën ventil edhe për qytetarët e BE-së së vjetër të 17 vendeve – vendimi përfundimtar pritet në fund të marsit. Në kemi biseduar me Rita Schiavi, drejtuese e sektorit të migracionit dhe anëtare e drejtorisë qendrore të Unia-s, mbi sfondet dhe pasojat e futjes rishtas të kontingjentëve.

Nëse klauzola ventil aktivizohet me të vërtetë në pranverë, cilat do të ishin pasojat për migrantët nga shtetet e BE-së?

Lejet B dhe L (për 8 vendet e BE-së) do të kontingjentohen, pra do të kufizohen. Kur të harxhohen kontingjentet dhe firmat megjithatë kanë nevojë për më shumë fuqi punëtorë, kanë gjithmonë mundësinë të punësojnë më shumë kalues kufiri apo edhe persona me qëndrim të kufizuar shkurtë. Ose të japin më tej më shumë mandatet firmave tjera të huaja, të cilat mandate ata i plotësojnë me punëtorë të dërguar. Kjo do të vijë në shprehje më shumë tek tregtia. Për migrantët e prekur kjo do të thotë se do të kenë vetëm punësim të kufizuar dhe nuk do të dinë se a do tu zgjatet punësimi dhe kështu nuk do të kenë mundësi të planifikojnë të ardhmen e tyre profesionale. Pastaj do të punësohen më shumë kalues kufiri edhe jashtë zonës kufitare, gjë që do të qojë në kohëzgjatje të rrugës deri në vend të punës.

Qeveria nënvizon gjithnjë e më shpesh rëndësinë e qarkullimit të lirë të personave për ekonominë zvicerane. Për çfarë arsye duhen kufizuar kjo tani?

Qeveria përmes kësaj shpreson që votuesit në lidhje me votimet e ardhshme nga fusha e politikës së migrimit (Ecopop- Iniciativa, Initiative e migrimit e Partisë Popullore të Zvicrës, të planifikuara për vitin 2014). Vërtetë qëndron rreziku se këto iniciativa do arrijnë shumicën tek popullata. Mirëpo unë besoj, se klauzola ventil është mjet i gabueshëm për të luftuar iniciativës për ndalimin e migrimit.

Cili është pozicioni i Unia-s dhe Unionit të Sindikatave Zvicerane për aktivizimin e klauzolës ventil?

Ne themi, ashtu si kemi potencuar para një viti, se klauzola ventil nuk bie asnjë ndryshim. Nëse është nevoja për punëtorë, atëherë punëmarrësit do të gjejnë rrugë, edhe përkundër klauzolës ventil të punësojnë fuqi punëtorë. Mirëpo për punëmarrësit e kjo domethënë se ata duhet të punojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe nuk do mund ta planifikojnë ardhmërinë tyre në Zvicër. Tek punonjësit me kualifikim shumë të mirë mund të ndodhë që do të ketë pengesa, pasi që këta pranojnë të vijnë në Zvicër, vetëm nëse u epet kontrata e pakufizuar. Kjo ka të bëjë me personelin shëndetësor, inxhinierët, kuadrot drejtuese, etj.

Si e vlerëson ti ardhmërinë e Marrëveshjes për qarkullim të lirë?

Unë mendoj se ka një rrezik, që zgjerimi i qarkullimit të lirë me Kroacinë, e cila këtë verë bëhet anëtare e BE-së, nuk do të ketë shumicën tek popullatës votuese. Do të jetë me rëndësi që të përmirësohen me efektivitet masat të zgjeruara për mbrojtje të kushteve të punës. Ne kemi nevojë para së gjithash për përgjegjësinë solidare, pasi që dumpingu i pagave në ekonomi tregtuese përmes nënkontraktuesve të dyshimtë është një realitet. Ligji për përgjegjësi të përbashkët solidare është aprovuar në Parlament. Mirëpo punëdhënësit me të gjitha mjetet janë duke provuar të ndikojnë që përgjegjësia solidare megjithatë të mos prek ata. Si duket punëdhënësit ende nuk e kanë vërejtur se do të rrezikojnë qarkullimin e lirë të personave, nëse nuk janë të gatshëm të bashkëpunojnë për zbatimin rigoroz zë masave shtesë për luftimin e keqpërdorimeve në këtë fushë.

➤ Aurora Garcia

Ekspertët zviceran këshillojnë reformën sindikale në Kosovë

Konferenca sindikale në Kosovë

Kosova duhet të fillojë një reformë ndër-profesionale sindikale për të evituar ndoshta copëzimin e mëtejshëm të lëvizjes sindikale. Kështu ka rekomanduar eksperti zviceran Hans Schappi, i cili ka thënë se reforma duhet filluar nga degët sindikale për të arritur deri tek qendra.

Në tryezën sindikaliste të datës 22 shkurt 2013 në Prishtinë, me temën: Të drejtave të punëtorëve dhe siguria sociale në Kosovë, folën edhe sindikalist vendës dhe të huaj.

Papunësi e madhe në Kosovë

Tryezën shpalli të hapur organizatori, Kryetari i Federatës Sindikale të Pavarur të PTK-së, Milazim Alshiqi. Ai ndër të tjera potencoi se: «Kjo gjendje është përcjellë me një papunësi e cila arrin deri në 45%. Si rezultat i kësaj papunësie, 45% e popullit të Kosovës jeton në varfëri, dhe 18% jeton në varfëri ekstreme – me më pak se 0.90 cent në ditë. Është tejet e arsyeshme që kjo gjendje e rëndë të ndikojë në tregun e punës, e veçanërisht në marrëdhënien në mes të kërkesës dhe ofertës, andaj, programet e rregullimeve strukturore të ekonomisë, përmes privatizimit të egër, e kanë rënduar edhe më shumë situatën e punëtorëve në Kosovë, si në aspektin e realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre, ashtu edhe në kushtet e tregut të punës», ka thënë ai.

Reforma ndër-profesionale në vend të copëzimit të sindikatave

Në konferencë morri pjesë edhe Hans Schappi, ekspert sindikal i pensionuar nga Zvicra. Ai fillimisht foli për kërkesat që shtrohen para Sindikatave duke pasur parasysh Globalizimin. Nga viti 1980 Internacionalizimi ka një kualitet të ri: Globalizimin, ndërsa forca shtyese me këtë rast janë koncernet multinationale, theksoi ai. Më pas ai theksoi disa nga pasojat e Globalizimit:

- Përkeqësimi i kushteve të punës, pabarazia në rritje e sipër, papunësia, prekariteti

- Shteti i konkurrencës: s'ka më formësim të ekonomisë, shteti cytë konkurrencën mes lokacioneve (të prodhimit), privatizimet, zbritja e tatimit: Fuqizon përkeqësimin e kushteve të punës
- Kriza e Sindikatave

Pos tjerash sipas tij kemi të bëjmë edhe me akumulimin përmes shpronësimit. Posaçërisht brutal ishte procesi i ristrukturimit neoliberal në vendet e Evropës jugore:

- Përvetësimi i (burimeve) resurseve (uni, toka, metalet, bimët e drunjtë) nga ana e koncernëve multinationale, privatizimet;
- Fundi i importeve zëvendëson industrializimin, Fokusimi në eksportin e lëndëve të para, prodhimi të lirë dhe zona të posaçme ekonomike;
- FMN (Fondi Monetar Ndërkombëtar), Banka botërore, OBT (Organizata Botërore e Tregtisë) sigurojnë akumulimin përmes shpronësimit në interes;
- Në këtë kontekst ka të bëjë edhe zhvillimet në ish-Jugosllavi që nga viti 1980 e deri tek zhdukja e saj.

Ristrukturimi i Lëvizjes Sindikaliste që nga viti 1990

Duke folur për përvijën e sindikatave zvicerane në rrugëtimin e tyre reformues, kolegu Hans Schappi më pas numëroi disa nga qëllime kryesore që ndiqte reforma sindikale në Zvicër:

- **Sindikatë ndër-profesionale:** Tejkalimi i principit të sindikatave sektoriale, për dy arsye: 1. mobiliteti i madh profesional, organizimi i të papunëve. 2. Përqendrimi i resurseve (burimeve)
- **Përforcimi i sindikatave nëpër regjione.** Zvicra është tejet e vogël, që secila sindikatë e sektorëve të

ndryshëm nëpër regjione të ndryshme, me gjuhë të ndryshme si dhe shumëllojshmëri e në numër të madh të emigrantëve në vend, nëpër ndërmarrje dhe regjione, të mundet të funksionojë drejtë e mirë.

- **Organizimi i shkretëtirave sindikale:** Në Zvicër sektori terciar i avancuar dhe me rëndësinë e tij në rritje e sipër. Pa këtë sindikatat do të humbnin vazhdimisht rëndësinë.
- **Organizimi i shtresave të reja:** rinia, gratë, imigrantët, me ndihmën e grupeve të interesit dhe sekretarëve përgjegjës sindikal.
- **Rifitimi (kthimi) i aftësisë mobilizuese, aftësisë së referendumeve.** Për këtë duhet edhe pavarësia politike (e sindikatave): Unia nuk është e përfshirë në politikën qeverisëse, është qartas një forcë anti-neoliberalë, forcë opozite: Kundër privatizimeve, fleksibilitetit të orarit të punës, për paga minimale.
- **Përforcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar:** Këtu është bërë më së paku. Është me rëndësi për shkak të Globalizimit.

Propozimet për sindikatat e Kosovës

«Do të ishte e nevojshme formulimi i një projekti sindikal me qëllime të qarta: Tejkalimi i copëzimit sindikal, ndërtimi ndër-profesional dhe ndër-sektorial, ankorim nëpër regjione, organizimi i shkretëtirave sindikale, rritja e aftësisë mobilizuese, pavarësia politike, përforcimi i bashkëpunimit me sindikatat e Evropës juglindore dhe në përgjithësi të Evropës. Pikënisje për jetësimin do të ishte kooperimi i sindikatave të veçanta përparimtare dhe të gatshme për reforma. Një reformë e tërësishme «nga lart», kjo d.m.th. përmes çatisë së sindikatave të bashkuara, edhe për Zvicrën, ishte një iluzion» ka thënë theksuar në fund eksperti sindikalist nga Zvicra Hans Schappi.

Osman Osmani, sekretar sindikal për migracion

Ju pyesni, Unia përgjigjet



Pensioni i invaliditetit (IV/AI): A e marr jashtë Zvicrës?

Jam portugez dhe kam punuar për shumë vite në Zvicër. Ka 4 vite që marrë një gjysmë pensioni invaliditeti. Qe dy vite jetoj tek shoqja ime në Kroaci. Pasi që fatmirësisht me shëndet jam pak më mirë, sigurimi i invaliditetit ma ka hequr gjysmë pensionin dhe tani më ka ndarë vetëm një çerek pensioni invaliditeti. Arka e sigurimit të invaliditetit refuzon të ma paguajë këtë pension, përderisa unë banojë në Kroaci. Çerek pensionet paguhen vetëm nëse personi i siguruar jeton në Zvicër. Këtu unë nuk mund ta besoj. A ka sigurimi i invaliditetit të drejtë?

Vetëm pjesërisht. Qytetarët zviceran marrin pensionet e invaliditetit pa marrë parasysh se ku ata banojnë. Gjithashtu edhe qytetarët e 27 vendeve të BE-së si dhe ata të tri shteteve të zonës së lirë tregtare evropiane Liechtenstein, Norvegjia dhe Islanda. Mirëpo: kjo vlen vetëm për pensionin e plotë, gjysmë pension dhe ¾ pension invaliditeti. Çerek pensionet këtyre personave u paguhen nëse kanë vendbanimin në Zvicër apo në shtetet e përmendura të BE-së dhe në njërin nga tri shteteve në fjalë. Pasi që si portugez jeni qytetar i BE-së, arka e sigurimit të invaliditetit ua ka paguar me të drejtë gjysmë pensionin në Kroaci. Pasi që tani keni të drejtën e një çerek pensioni, mjerisht nuk keni të drejtë ta merrni. Pasi Kroacia (ende) nuk është vend i BE-së. Ndryshe qëndron puna me persona që nuk janë nga vendet e BE-së dhe zonës së lirë tregtare evropiane. Për këta është vendimtare se a ka marrëveshje ndërshtetërore për sigurimet shoqërore mes Zvicrës dhe vendit amë të tyre. Në rast se ka marrëveshje pensionet (me përjashtim të çerek pensionit) do të paguhen pa marrë parasysh në cilin vend jeton personi. Nëse nuk ekziston Marrëveshja ndërshtetërore mbi Sigurimet Shoqërore, atëherë pensionet e invaliditetit paguhen vetëm nëse posedohet vendbanimi në Zvicër. Rregullimi juridik pra mjerisht është mjaft i komplikuar. Andaj mos ngurroni të informoheni te sekretariati juaj i Unia-s.

Peter Schmid, work, 31.1.2013

I papunë: A guxoj të ruaj veprimtarinë time anësore?

Unë krahas punësimit tim 80%, punoj edhe si i pavarur si kreator faqesh interneti. Për myshterijë rregulloj faqet e internetit dhe i mirëmbaj ato. Tani kam humbur punën time të përhershme 80% dhe jam i papunë. Mirëpo edhe më tej kam mandate për punë të faqeve të internetit. Nëse unë lajmërohem tek enti regional për ndërmjetësim pune dhe kërkoi kompensimin për çështje papunësie, a kam mundësi të vazhdojë të ushtrtoj edhe më tej këtë veprimtari të pavarur ekonomike, apo duhet të heq dorë nga kjo.

Nëse veprimtarinë e juaj në fjalë nuk e zgjeroni dhe ndërmjetësimi juaj për punë nuk ju kufizohet nga ky shkak, atëherë mund ta bëni edhe më tej këtë punë. Pasoja nga kjo gjatë periudhës së papunësisë nuk do të keni. Ju duhet të kërkoni punë dhe të jeni në gjendje ta merrni përsipër një punë për vetëm 80%. Shkurt: Veprimtaria e juaj e pavarur nuk guxon të pengoj apo pamundësoj aftësinë e juaj të ndërmjetësimit për punë 80%. Për këtë arsye Enti për ndërmjetësim të punës (RAV/ORP) do të kërkojë të dhëna të sakta për këtë veprimtari të pavarur (Përqindja, koha e zënë). Ju jeni i detyruar çdo zgjerim të veprimtarisë së pavarur gjatë papunësisë ta lajmëroni pa vonesë në Entin e papunësisë dhe e ndërmjetësimit për punë (RAV/ORP).

Timur Öztürk, work, 15.2.2013

Ftesë për tubim informativ dhe kuvendues

Sindikata Unia është ndër të tjera edhe organizata më e madhe e migrantëve. Përpos për realizimit dhe mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve në botën e punës, Unia angazhohet edhe për përmirësimin e pozitës shoqërore dhe ligjore të të huajve në Zvicër. Në kuadër të aktiviteteve sindikale dhe mbështetur në përcaktimet e mirënjohura Unia parapëlqen që me anëtarësinë të komunikojë në gjuhën e tyre amtare.

M kërkesën e disa punëtorëve shqiptar, anëtarë të sindikatës Unia dhe me iniciativën tonë organizojmë një mbrëmje informative dhe kuvenduese me dhe për punëtorët e komunitetin shqiptar:

Të enjten, më 11 prill 2013, uke filluar në ora 18:00

Në lokalet e sindikatës Unia të Gjenezës: Chemin Surinam 5, 1211 Genëve 13

Në këtë takim do të trajtojmë bashkërisht temat vijuese:

1. Situata e punëtorëve dhe personave pa status të rregulluar, personave pa letra (Sans-Papiers). Në veçanti de të informoheni me kompetencë mbi përkeqësimet aktuale (masat shtrënguese e ndëshkuese).
2. Marrëveshja ndërshtetërore mbi Sigurimet Shoqërore mes Zvicrës dhe Kosovës dhe mosmarrëveshjet përcjellëse të kësaj çështjeje të komplikuar.
3. Bashkëbisedim për të identifikuar nevojat dhe preokupimet me rëndësi të punëtorëve si dhe të komunitetit shqiptar në Gjenezë dhe Zvicër.

Me shpresë se do të zhvillojmë një bashkëpunim të frytshëm me pjesëmarrje të mjaftueshme dhe aktive, me ide e propozime konkrete, ju përsëhendes dhe ju uroj mirëseardhje!

Për pyetje të mundshme përpos me E-mail mund të na drejtoheni edhe me telefonin.

Me nderime

Nasuf Nuhiu, sekretari sindikal i Unia-s të regjionit të Gjenezës (nasuf.nuhiu@unia.ch, +41 79 915 65 51)

Impressum: Bellage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. Garcia, D. Filipovic, E. Sariaslan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck Ringier Print, Adligenswil | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch